

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**Forca Tokësore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Teknik i mesëm saldator/xhenerik	Rep. usht. nr.1002 në FT.	Zall-Herr Tiranë.	E pacaktuar	Me dosje	Nuk aplikohet	01.05.2020	15.05.2020

Formulari nr.1

1. Pozicioni i punës:	“Teknik i mesëm (saldator/xhenerik)” , në skuadrën e riparimeve, në togën logjistike, në repartin ushtarak nr.1002 në Forcën Tokësore.
2. Kodi i pozicionit:	C2, (Civil II).
3. Reparti/Institucioni:	Reparti ushtarak nr.1002 në Forcën Tokësore.
4. Vendi:	Zall-Herr, Tiranë.
5. Paga:	VKM Nr. 202 datë 15.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717 datë 23.06.2009”, “Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës:	E pacaktuar.
7. Data e fillimit të aplikimit:	01.05.2020
8. Data e mbylljes së aplikimit:	15.05.2020
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit:	- Kërkesë. - Formularin e aplikimit. - Fotokopje të kartës së identitetit. - Diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare, diplomën e shkollës së lartë të noterizuar ose në origjinal. - Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit nëse ka. - Dëshmi profesioni nëse ka. - Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja, nëse ka. - Raport mjekësor. - Fotografi me përmasa 4x6, 2-copë. - Dëshmi penaltetit. - Vërtetim nga gjykata. - Vërtetim nga Prokuroria. - Librezë pune. - Jetëshkrimin CV. - Formularin e vetëdeklarimit.
11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:	- Të ketë shtetësinë shqiptare. - Të jetë jo më pak se 18-vjeç. - Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar. - Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara. - Të jetë i aftë për punë nga ana shëndetsore. - Të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi. - Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda një viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil II, (C2).
- b. Arsimi: Të ketë kryer arsimin e mesëm profesional, për specilitetin e kërkuar.
- c. Kualifikimi: Të ketë përvojë pune dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara.
- d. Trajnimi: Të ketë kryer trajnime për specialitetin e kërkuar, të jetë i paisur me dëshmi përkatëse.
- e. Eksperienca në punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në punë në fushën që mbulon.
- f. Gjuha e huaj: -----.
- g. Kërkesa të tjera specifike: -----.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: -----.

13. Përshkrimi i punës:

- a. Detyrat kryesore: **“Teknik i mesëm (saldator/xhenerik)”**, në skuadrën e riparimeve, në togën logjistike, në repartin ushtarak nr.1002 në Forcën Tokësore, kryen këto detyra dhe mban përgjegjësi:
 - Të njohë llojet e saldimit, aparatet e saldimit elektrik me oksigjen dhe argon.
 - Të njohë dhe të përdorë veglat e punës dhe lëndën e parë.
 - Të bëjë saldime vertikale dhe të precizionit.
 - Të dijë të bëjë saldimin e enëve nën presion.
- b. Përgjegjësitë: Të mbajë pastër dhe me rregull vendin e punës dhe ambientin rreth tij.
Të jetë i gatshëm në çdo kohë për zbatimin e detyrave që i jepen.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3-(tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake.
- Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve të lidhura me fushën përkatëse.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Tokësore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Komisioni, me mbylljen e aplikimeve, verifikon dokumentacionin e aplikantëve nëse ai është i plotë dhe i saktë si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Kandidatët njoftohen nëse janë përzgjedhur ose jo për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse).

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas listë meritës. Pas listimit të 3-tre kandidatëve, i paraqitet autoriteteve kompetente një memo miratuese për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

Me emërimin në pozicionin e punës, do të lidhet kontrata individuale e punës.